



Bordi i Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP),

Në mbështetje të neneve 15.2.1 të Ligjit të AKP-së,

Miraton:

**RREGULLORJA NR. 2/2022 PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE
KADASTRALE QË LIDHEN ME PARCELAT NË FQINJËSI TË PARCELAVE NË
PRONËSI TË NDËRMARRJËVE SHOQËRORE**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave të shqyrtimit të kërkesave kadastrale të inicuara nga AKP apo nga palët e treta, në rastet kur kërkohet pëlqimi apo aprovimi i pronarëve të parcelave në fqinjësi. Kjo rregullore vlen në rastet e procedurave kadastrale lidhur me pronat e Ndërmarrjeve Shoqërore si në vijim:
 - 1.1.krijimi i parcelave të reja nga ndarja apo bashkimi;
 - 1.2.piketimi i kufijve të parcelave;
 - 1.3.ri-rregullimi i kufijve të parcelave në fqinjësi;
 - 1.4.identifikimi – rindërtimi i njësive kadastrale;
 - 1.5.korrigjimi i sipërfaqeve të njësive kadastrale.
2. Rastet e cekura si në paragrafin 1 nuk mund të përbullen në Zyrat Kadastrale Komunale apo Agjencinë Kadastrale të Kosovës, pa e siguruar pëlqimin apo aprovimin e pronarit të parcelave në fqinjësi, e që në rastin konkret i referohemi pronave në pronësi të Ndërmarrjeve Shoqërore.
3. Çdo person (subjekt fizik dhe juridik) mund të parashtroj kërkesë në AKP që t'i njihet e drejta për një proces të drejtë që ngërthen mes tjerash përcaktimin e vlefshmërisë së pretendimit të palës lidhur me fqinjësinë.

**Neni 2
Përkufizimet**

1. **“Parcela kadastrale”** – nënkupton sipërfaqe e përkufizuar e tokës e identifikuar me numër të parcelës dhe e regjistruar në hartën kadastrale me sipërfaqe reale në projeksionin hartografik dhe sipërfaqe të regjistruar në regjistrin e të drejtave mbi pronat e paluajtshme (RDDP).
2. **“Kufiri”** – një objekt fizik që shënon kufijtë e parcelës apo një vijë e imagjinuar apo një sipërfaqe që shënon ndarjen e dy parcelave. Gjithashtu përdoret për të përshkruar ndarjen në

mes të pjesëve me karakteristika të ndryshme administrative, juridike, shfrytëzimit të tokës dhe topografisë apo karakteristikave tjera. Kufiri i nxjerrë nga Harta kadastrale ka përparësi ndaj kufijve të tjerë.

3. Termat dhe përkufizimet tjera i referohen legjislacionit në fuqi në fushën e kadastrit.

Neni 3 Barazia e palëve

Procesi për shqyrtimin e kërkesave kadastrale, kryhet përmes një procesi të hapur, transparent dhe parimit të barazisë së palëve (parashtruesit dhe Agjencisë), mosdiskriminimit në raport me qytetarët dhe personat juridik të cilët paraqiten si palë me interes juridik pranë Agjencisë.

Neni 4 Statusi i palëve

Në çdo rast kur iniciohet procedura për marrjen e pëlqimit apo aprovimit për përbylljen e procedurës kadastrale, në varësi të faktave dhe rr Ethanave, përbajtjes së pretendimeve, provave dhe bazës juridike të kërkesës dhe kompleksitetit të çështjes, analizohet paraprakisht interesu juridik i parashtruesit (legitimacioni i palës) dhe e drejta e tij që të jetë palë në procedurë.

Neni 5 Kriteret

1. Kriter bazë për shqyrtimin e kërkesave për rastet si në nenin 1 të kësaj rregulloreje është që prona e parashtruesit të kërkesës të jetë në kufi me pronën e Ndërmarrjes Shoqërore dhe anasjelltas.
2. Raste tjera të cilat nuk janë përfshirë në kriterin e përcaktuar si në paragrafin e mësipërm kurse për nga karakteristikat dhe vjetitë e tyre cilësohen për shqyrtim sipas propozimit të argumentuar nga Njësia e Kadastrit dhe aprovuar sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje.

Neni 6 Subjektet në procedurë

Inicimin e procedurës për shqyrtimin e një rasti kanë të drejtë ta bëjnë çdo subjekt fizik dhe juridik, i cili ka interes juridik për iniciimin e procedurës, organizatë joqeveritare, komunitet i organizuar apo ngjashëm.

Neni 7 Inicimi i procedurës

1. Inicimi i procedurës, nënkupton paraqitjen e kërkesës me shkrim nga pala e interesuar apo kërkesa nga AKP ndaj palëve të treta.

2. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet i tërë dokumentacioni siç është i përcaktuar me Kornizën e Punës të Agjencisë Kadastrale të Kosovës me nr. AKK 2020/01, edhe sipas ndryshimeve të kësaj kornize në të ardhmen.
3. Agjencia ka të drejtë në çdo kohë gjatë rrjedhës së procedurës të kërkoj nga palët/parashtruesit prova, shpjegime ose dëshmi shtesë me karakter relevant.

Neni 8

Procedura e shqyrtimit të kërkesave të parashtruara nga palët e treta

1. Me parashtrimin e kërkesës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në zyrety rajonale apo në zyrën qendrore) nga palët e ndryshme, dosja fizike dhe elektronike përcillet në zyre të Drejtorit Menaxhues dhe kjo e fundit pa vonesa e përcjellë për shqyrtim Njësisë së Kadastrit.
2. Njësia e Kadastrit i verifikon të dhënat e asetit lëndor, analizon ekspertizat e ekspertëve të gjeodezisë (të dhënat tekstuale dhe grafike) dhe analiza tjera eventuale dhe shpreh konstatimet e tij nga kuadri i kompetencave të tij sipas ligjit. Në rastin e vizitave në terren, këto vizita i autorizon Kryesuesi i Njësisë së Kadastrit.
3. Komunikimet me palën gjatë shqyrtimit të kërkesës bëhen nga Njësia e Kadastrit në pajtim me nenin 7.3 të kësaj rregulloreje.
4. Njësia e Kadastrit e shqyrton kërkesën konform kësaj Rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi në fushën e kadastrit, brenda 5 ditë pune me mundësi vazhdimi për raste specifike, por jo më shumë se 10 ditë pune, duke mos anashkaluar prioritetet e AKP-së.
5. Njësia e Kadastrit e jep rekomandimin për aprovim apo refuzim dhe përmes procedurave të brendshme (Memorandum i Brendshëm) të nënshkruar nga Kryesuesi i Njësisë së Kadastrit, përmes Drejtorit të Departamentit të Shitjes, Zëvendës Drejtorit Menaxhues-Shitje, lënda dërgohet te Drejtori Menaxhues për aprovim apo refuzim përfundimtar.

Neni 9

Procedura e shqyrtimit të kërkesave të parashtruara nga AKP

1. Kërkesa sipas këtij neni inicohet nga zyrtari përgjegjës i NSH-së në bashkëpunim me zyrtarin kadastral, duke respektuar kriteret e aprovuara me këtë rregullore. Menaxheri i Zyrës Regionale dhe udhëheqësit e ekipeve të Likuidimit/Privatizimit informohen dhe janë kontributin e tyre në përgatitjen e propozimit. Nëse NSH-ja është në likuidim, atëherë Zyrtari i Rastit i NSH-së përkatëse e merr së pari miratimin nga Kryesuesi i Autoritetit të Likuidimit para se të inicoj procesin.
2. Zyrtari përgjegjës i NSH-së ne bashkëpunim me zyrtarin kadastral e përgatisin dosjen ku përshkruhet propozimi dhe të njëjtën e dërgojnë në formë elektronike te Drejtori i Departamentit të Koordinimit Rajonal dhe Udhëheqësi i Njësisë së Kadastrit.

3. Drejtori i Departamentit të Koordinimit Rajonal në bashkëpunim me Kryesuesin e Njësisë së Kadastrit shqyrtojnë kërkesën brenda 5 ditë pune me mundësi vazhdimi për raste specifike, por jo më shumë se 10 ditë, duke mos anashkaluar priorititetet e AKP-së.
4. Drejtori i Departamentit të Koordinimit Rajonale dhe Kryesuesi i Njësisë së Kadastrit e jep rekomandimin për aprovim apo refuzim dhe përmes procedurave të brendshme (Memorandumi i Brendshëm) të nënshkruar nga Kryesuesi i Njësisë së Kadastrit, lëndë dërgohet te Drejtori Menaxhues për aprovim apo refuzim përfundimtar.
5. Zyrtari kadastral në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës të NSH-së, koordinon, mbikëqyr dhe kontrollon, nëse përcaktimi i kufinjve nga gjeodeti i licencuar për matje kadastrale është kryer në pajtim me propozimin e aprovuar.


Neni 10
Procedurat përfundimtare

Procedurat përfundimtare i nënshtrohen Ligjit për Kadastër, Udhëzimeve administrative si dhe Kornizës së Punës Nr. AKK 2020/01 për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale si dhe legjislacionit në fuqi në fushën e kadastrit.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Prishtinë, më 28 prill 2022.

Nazmi Mikullovci

Kryesues i Bordit të Drejtoreve
Agjencia Kosovare e Privatizimit